



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr.

2174

Prishtinë, Dt.

04-07-2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	GJEOGRAFI
Projektpropozimi	"Transformimi hapësinor dhe urbanistik i vendbanimeve përgjatë sektorit rrugor Komoran - Polluzhë në komunën e Glllogocit" " Spatial and urban transformation of settlements along the Komaran - Polluzhe road sector in the municipality of Glllogoc "
Kandidati	Elhami ISUFI
Mentori	Prof. Asoc. Ibrahim Ramadani
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 28.03.2025 Vendimi nr.: 1081
Vlerësimi i dorëshkrimit Kandidati Elhami ISUFI ka paraqitë kërkesën për vlerësim të dorëshkrimit në punimin e temës së diplomës-master, me titull "Transformimi hapësinor dhe urbanistik i vendbanimeve përgjatë sektorit rrugor Komoran - Polluzhë në komunën e Glllogocit" " Spatial and urban transformation of settlements along the Komaran - Polluzhe road sector in the municipality of Glllogoc ". Tema është nga fusha e planifikimit të hapësinor, prandaj paraqet fushë interesi për shkencën dhe shoqërinë, me qëllim që ky territor të jetë sa më funksional, atraktiv dhe i qëndrueshëm për banorët e kësaj hapësire. Planifikimi dhe zhvillim i qëndrueshëm është një aktivitet multidimensional që përcaktohet në bazë të metodave dhe qasjes së institucioneve publike dhe private me qëllim të harmonizimit hapësinor të të gjitha aktiviteteve në hapësirë. Qëllimi i këtij hulumtimi është të ofrojë një trajtim të gjithanshëm të problematikës, duke siguruar një analizë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse si në nivelin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Në këtë kuadër, punimi do të fokusohet në shqyrtimin e 9 vendbanimeve pranë rrugës Komaran-Polluzhë (Komaran, Zabel i Ultë, Korroticë e Poshtme, Poklek i Ri, qyteza e Glllogocit, Çikatova e Re, Glllobar, Terrstenik dhe Polluzhë). Trajtimi i ndryshimeve hapësinore dhe funksionale në këto vendbanime do të bëhet për një	

periudhë 20 vjeçare pas luftës së fundit. Vendbanimet e përmendura kanë qenë subjekt i hulumtimeve të mëparshme nga autori i këtij punimi gjatë fazës së studimeve themelore, dhe për këtë arsye, qëllimi është të krahasohen ndryshimet apo transformimet që kanë ndodhur gjatë periudhës nga viti 2001 e deri më sot. Analiza do të përfshijë karakteristikat hapësinore të këtyre vendbanimeve, duke vlerësuar shtrirjen e tyre, madhësinë, funksionin (social-ekonomik), morfologjinë, lëvizjet numerike të popullsisë, si dhe kalimin e popullatës në sektorët e ndryshëm socio-ekonomikë.

Detyrat kryesore të këtij hulumtimi përfshijnë:

- Analizimin e literaturës shkencore lidhur me organizimin hapësinor dhe funksional të vendbanimeve, me një fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe praktikave më të avancuara të menaxhimit hapësinor;
- Vlerësimin kritik të modeleve teorike dhe praktikave që kanë rezultuar nga hulumtimet e mëparshme në këtë fushë, me qëllim identifikimin e tendencave dhe sfidave të mundshme;
- Analizën e praktikave dhe strategjive të implementuara në kontekstin nacional, si dhe vlerësimin e ndikimit të politikave të zhvillimit lokal;
- Realizimin e krahasimeve ndërkombëtare me praktikave të tjera, për të nxjerrë mësim dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësimin e organizimit hapësinor në nivel lokal.

Ky studim bazohet në identifikimin, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura në terren. Tema e punimit ka një fokus të qartë në planifikimin hapësinor, ku, përveç analizës së gjendjes ekzistuese, trajtohen parashikimet në fusha të ndryshme, përfshirë ato socio-ekonomike, infrastrukturore, dhe të zhvillimit të banimit, duke analizuar indikatorët e transformimit hapësinor, demografik dhe funksional të këtij territori.

Pra, ky hulumtim synon të vlerësojë dhe të identifikojë format e vendbanimeve të promovuara në këtë rajon dhe të shqyrtojë mënyrën se si trajtohen konfliktet zhvillimore në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të analizojë faktorët e ndryshimeve në strukturën funksionale dhe hapësinore, të krahasojë këto ndryshime në periudha të ndryshme kohore si dhe të nxjerrë përfundime për ngjashmëritë në mes tyre. Aspekti kohor apo historik luan një rol të rëndësishëm si në morfologjinë apo fizionominë e vendbanimeve ashtu edhe në mënyrën e organizimit hapësinor në aspektin kohor. Analiza e këtij punimi është fokusuar edhe tek nder ndikimet e pozitës gjeografike, centralitetit të ndonjërit nga vendbanimet ndaj vendbanimeve tjera, aspekti gravitacional i tërheqjes së popullatës si në aspektin hapësinor horizontal ashtu edhe në atë vertikal, ndikimeve të tyre në mjedis dhe në cilësinë e jetesës së popullatës. Duke aluduar në këto përfundime, hipoteza do të bazohet tek transformimet e vendbanimeve në vazhdimësi si rezultat i faktorëve të ndikimit reciprok në mes të faktorëve natyror dhe shoqëror. Dhe si rrjedhojë detyrimisht planifikime urbane dhe hapësinore të ditëve moderne që qojnë drejt proceseve të ndërveprimit rajonal.

Tema e punimit është trajtuar në nëntë kapituj. Në pjesën hyrëse, shpjegohen qëllimi dhe metodologjia e përdorur, konceptet bazë të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe një vlerësim kritik i proceseve të planifikimit hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Pjesa e dytë e punimit, e cila ka karakter të veçantë, analizon gjendjen ekzistuese të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në këtë rajon, duke shqyrtuar zhvillimet dhe transformimet bashkëkohore, si dhe perspektivën e zhvillimit të këtij sistemi.

Struktura e punimit:

Ky punim është i ndarë në nëntë (9) kapituj, si vijon:

KAPITULLI I: Hyrja

Ky kapitull përfshin qëllimin e hulumtimit, metodologjinë e përdorur dhe një vlerësim të studimeve të deritanishme. Qëllimi i punimit është të analizojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe planifikimin hapësinor, duke përdorur metoda të ndryshme kërkimore për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

2. KAPITULLI II: Karakteristikat e përgjithshme hapësinore të vendbanimeve

Ky kapitull trajton konceptin e vendbanimeve, klasifikimin e tyre dhe analizën e faktorëve gjeo-hapësinorë që ndikojnë në zhvillimin e këtyre vendbanimeve. Përveç karakteristikave natyrore-gjeografike, trajtohen edhe zhvillimet e gjithmbarshëm të vendbanimeve siç janë edhe elemente tjera shoqërore si gjeneza (aspekti historik-politik) i zhvillimit të tyre, karakteristikat funksionale, rrjeti dhe lidhja komunikative, karakteristikat demografike etj. Analizohen pozita fiziko-gjeografike, kufijtë dhe forma e vendbanimeve përgjatë sektorit rrugor Komoran-Polluzhë, duke ofruar një pasqyrë të detajuar të strukturës së tyre.

2. KAPITULLI III: Transformimi hapësinor dhe morfologjiko-urbanistik i vendbanimeve

Ky kapitull fokusohet tek karakteristikat urbanistike, organizimin kadastral dhe komunikativ të vendbanimeve pranë rrugore Komoran – Polluzhë, tendencat në planifikimin dhe rregullimin e mjedisit rural, zgjerimi i infrastrukturës urbane si dhe shqyrton ndikimin që planifikimi dhe zhvillimi i hapësirës kanë në jetesën e banorëve.

KAPITULLI IV: Tipologjia e vendbanimeve pranë rrugës Komoran-Polluzhë

Ky kapitull analizon tipologjinë e vendbanimeve, duke u përqendruar në tipizimin e vendbanimeve sipas madhësinë demografike dhe normave të planifikimit hapësinor për vendbanimet, tipizimi i vendbanimeve sipas ritmit të rritjes së popullsisë së vendbanimeve pranë rrugore Komoran-Polluzhë që ka të bëjë me diferencimin e vendbanimeve sipas kategorive dhe ritmit të rritjes ose zvogëlimit demografik si rezultat i faktorëve të cilët kanë shkaktuar në ndryshimet sipas kategorive të madhësisë demografike. Më pastaj vazhdohet më ndryshimet morfologjike të vendbanimeve rurale dhe urbane, tipizimi i tyre sipas morfologjisë apo formës dhe tipizimin funksional e ekonomik të vendbanimeve pranë rrugore Komoran – Poluzhë me metodën e shkallëzimit, më ç'rast analizohen tipizimi funksional dhe ekonomik i njësive gjeografike territoriale që është një punë me vlerë shkencore e praktike, ngase e mundëson përcjelljen e transformimit shoqëror e ekonomik prej një niveli në tjetrin, gjegjësisht prej një modeli në tjetrin për kohë të caktuar.

KAPITULLI V: Analiza e kushteve natyrore në Komunën e Drenasit

Ky kapitull shqyrton kushtet natyrore që mundësojnë zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit, përfshirë analizën e përbërjes gjeologjike, strukturës relievoe, klimës, ujërave, dherave dhe biodiversitetit. Ai vlerëson si këto faktorë ndikojnë në planifikimin e territorit dhe menaxhimin e resurseve natyrore.

KAPITULLI VI: Infrastruktura sociale

Ky kapitull analizon infrastrukturën sociale të vendbanimeve, përfshirë infrastrukturën e arsimit, organizimi i sistemit arsimor në këto vendbanime, infrastrukturën shkollore, problematikat me lokacionet e tyre dhe ndryshimet e vazhdueshme me numrin e nxënësve duke krahasuar vendbanimet rurale me ato të qendrës urbane. Shtrirjen dhe mbulueshmërinë e hapësirës në shqyrtim me institucionet shëndetësore, shërbimeve publike dhe administrative si dhe hapësirave

të sportit dhe rekreative. Ai shqyrton mundësitë për përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët përmes investimeve në këto fusha.

KAPITULLI VII: Infrastruktura teknike

Ky kapitull fokusohet në analizën e infrastrukturës teknike të vendbanimeve, përfshirë furnizimin me ujë e vendbanimeve, shtrirja e rrjetit të ujësjellësit, rrjetin e trafikut, kanalizimin, energjinë elektrike dhe menaxhimin e mbeturinave. Ai ofron rekomandime për përmirësimin e këtyre sistemeve për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.

KAPITULLI VIII: Mjedisit dhe peizazhi

Ky kapitull trajton ndikimin e trashëgimisë natyrore dhe risqet mjedisore në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit. Ai ofron një analizë të pasurive natyrore dhe masave mbrojtëse që mund të merren për të siguruar ruajtjen e mjedisit.

KAPITULLI IX: Përfundimi dhe rekomandimet

Në këtë kapitull, përmbledhen gjetjet kryesore të studimit dhe ofrohen rekomandime për politikën dhe strategjitë që duhet të ndjekin autoritetet lokale për të inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm. Rekomandimet përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës, menaxhimin e mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët.

Në përfundim të këtij hulumtimi, u arrit në disa përfundime të rëndësishme që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm të vendbanimeve përgjatë sektorit rrugor Komaran - Polluzhë (Drenas) në periudhën 2001-2024. Ky studim ka ofruar një analizë të thelluar të organizimit hapësinor dhe funksional të këtij territori, duke identifikuar faktorët dhe proceset që kanë ndikuar në transformimet urbane dhe zhvillimin e vendbanimeve, si dhe ndikimin e këtyre zhvillimeve në kushte socio-ekonomike, mjedisore dhe infrastrukurore.

Ndër përfundimet kryesore të studimit janë se këto vendbanime kanë pasur transformime të ndryshme si në aspektin popullativ, funksional ekonomik por edhe në atë funksional të organizimit hapësinor. Gjatë analizës së rregullimit dhe organizimit hapësinor të vendbanimeve pranë rrugore Komaran-Polluzhë, nga organet kompetente komunale në hartimin e PZHK-së së tyre për të ardhmen do të krijohet nevoja e një organizimi më të mirë hapësinorë të këtyre vendbanimeve dhe si rezultat i kësaj edhe ndërtimit të kapaciteteve dhe llojeve të ndryshme të objekteve shoqërore dhe publike. Kërkohej në të ardhmen që të ketë investime dhe përkrahje më të shumta tek bizneset e mesme që gjenerojnë numër më të madh të të punësuarve dhe rrjedhimisht edhe zhvillim më të lartë ekonomik të tërë komunës. Ngritja e kapaciteteve të reja të infrastrukturës sociale dhe asaj teknike në përgjithësi për një zhvillim më të qëndrueshëm social dhe ekonomik si dhe përmirësimin e jetesës së qytetarëve në çdo aspekt.

Megjithatë, ky zhvillim ka sjellë sfida të ndryshme për qëndrueshmërinë e territorit, siç janë pasiguria në menaxhimin e burimeve natyrore, ngarkesa mbi infrastrukturën dhe mungesa e një planifikimi të mirë strukturuar dhe të koordinuar. Konfliktet e qëndrueshmërisë në këtë rajon janë të lidhura ngushtë me një zhvillim urban që shpesh nuk është në përputhje me parimet e planifikimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit të resurseve.

Në trajtimin e këtyre gjetjeve, ky punim propozon disa masa dhe rekomandime që mund të kontribuojnë në përmirësimin e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendbanimeve përgjatë sektorit rrugor Komaran - Polluzhë:

1. **Përmirësimi i planifikimit hapësinor:** Duhet të zhvillohet një planifikim më i mirë koordinuar dhe i qëndrueshëm, i cili të përfshijë faktorët socio-ekonomikë, ekologjikë dhe urbanistikë. Ky planifikim duhet të synojë ruajtjen e ekuilibrave natyrorë dhe të

- sigurojë zhvillimin e infrastrukturës pa dëmtuar mjedisin dhe pasuritë natyrore të rajonit.
2. **Zhvillimi i infrastrukturës qendrore dhe rurale:** Përmirësimi i infrastrukturës është thelbësor për mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm. Rekomandohet investimi në sisteme infrastrukturore të avancuara për furnizimin me ujë, kanalizimin, trafikun dhe menaxhimin e mbeturinave, për të siguruar kushte më të mira jetese për banorët dhe për të lehtësuar zhvillimin e bizneseve të qëndrueshme.
 3. **Mbështetje për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm:** Për të stimuluar një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, duhet të promovohen sektori i turizmit dhe bujqësia e qëndrueshme. Iniciativat për zhvillimin e këtyre sektorëve mund të kontribuojnë në rritjen e mundësive për punësim dhe zhvillim ekonomik, duke mbrojtur gjithashtu mjedisin dhe burimet natyrore.
 4. **Përfshirja e komunitetit në proceset e planifikimit dhe zhvillimit:** Një tjetër rekomandim është angazhimi i komunitetit në proceset e planifikimit dhe zhvillimit, përmes krijimit të platformave për pjesëmarrje qytetare dhe konsultimeve. Ky proces do të ndihmojë në identifikimin e nevojave të banorëve dhe do të sigurojë që zhvillimi të jetë në harmoni me interesat dhe kërkesat e komunitetit.
 5. **Promovimi i praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit:** Duhet të bëhen hapa konkretë për menaxhimin e resurseve natyrore, përfshirë ruajtjen e biodiversitetit, ujërave dhe tokave bujqësore. Kjo do të kontribuojë në sigurimin e një balancimi mes zhvillimit të vendbanimeve dhe ruajtjes së mjedisit.
 6. **Politika të koordinuara dhe mbështetje institucionale:** Rekomandohet që autoritetet lokale të zhvillojnë politika të koordinuara dhe të mbështesin krijimin e institucioneve që mund të monitorojnë dhe menaxhojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo do të mundësojë një menaxhim më të mirë të territorit dhe do të kontribuojë në realizimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në afatgjatë.

Në përfundim, ky studim ka dhënë një pasqyrë të rëndësishme të transformimeve urbane dhe zhvillimeve socio-ekonomike në sektorin rrugor Komaran - Polluzhë, duke ofruar gjithashtu një sërë rekomandimesh që mund të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij rajoni. Implementimi i këtyre masave do të sigurojë një balancë mes zhvillimit të vendbanimeve, ruajtjes së mjedisit dhe promovimit të një ekonomie të qëndrueshme dhe sociale.

KONKLuzioni DHE PROPOZIMI

Në përfundim të vlerësimit të dorëshkrimit të temës së masterit të kandidatit **Elhami ISUFI**, me titull "**Transformimi hapësinor dhe urbanistik i vendbanimeve përgjatë sektorit rrugor Komoran - Polluzhë në komunën e Glllogocit**"

" **Spatial and urban transformation of settlements along the Komaran - Polluzhe road sector in the municipality of Glllogoc** "mund të nxirren këto konkluzione kryesore:

1. **Tematika e përzgjedhur** për këtë tezë është origjinale dhe i kushtohet një analize të thelluar të një hapësire dhe periudhe kohore që është relativisht pak e trajtuar në literaturën gjeografike dhe në atë të planifikimit hapësinor. Kjo temë paraqet një kontribum të vlefshëm në fushën e studimit të organizimit hapësinor dhe funksional të vendbanimeve, duke trajtuar një zonë të caktuar, të rëndësishme për zhvillimin urban dhe

rural në këtë sektor të Kosovës.

2. **Përdorimi i të dhënave dhe metodologjisë** është në përputhje me standardet shkencore, duke siguruar një analizë të detajuar të zhvillimeve hapësinore dhe funksionale përgjatë periudhës kohore të shqyrtuar. Të dhënat e grumbulluara dhe të analizuar, si dhe format e ndryshme grafike të përpiluara për këtë hapësirë, jo vetëm që kanë një vlerë të lartë shkencore, por janë gjithashtu të dobishme për praktikën e planifikimit hapësinor dhe zhvillimin e mëtejshëm të kësaj zone. Këto të dhëna ofrojnë një bazë solide për planifikimin dhe menaxhimin e vendbanimeve, si dhe për krijimin e strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm.

Mbështetur në vlerësimet dhe konkluzionet e mësipërme, Komisioni profesional ka vlerësuar se punimi i masterit të kandidatit **Elhami ISUFI**, me titull "**Transformimi hapësinor dhe urbanistik i vendbanimeve përgjatë sektorit rrugor Komoran - Polluzhë në komunën e Glllogocit**"

" **Spatial and urban transformation of settlements along the Komoran - Polluzhe road sector in the municipality of Glllogoc** "i plotëson të gjitha kërkesat formale, juridike dhe shkencore-profesionale për të kaluar në procedurat e mëtutjeshme të shqyrtimit dhe miratimit të kësaj teze. Ky punim është një kontribim i rëndësishëm në fushën e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, dhe është një shembull i shkëlqyer i përdorimit të metodologjive moderne për studimin e hapësirave urbane dhe rurale.


Prishtinë, 04.07.2025

Komisioni:


1. Prof. Asoc. Ferim GASHI- kryetar



2. Prof. Asoc. Ibrahim RAMADANI - anëtar



3. Prof. Dr. Arsim EJUPI anëtar



P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.